

HALID SHAIJIË



DISA GABIME

GJATË

VIZITËS SË VARREZAVE



Halid Shaijië

DISA GABIME
GJATË VIZITËS SË
VARREZAVE



Titulli i origjinalit:

تنبيهات حول بعض المخالفات الواقعة في المقابر

**Tenbihat haul bad muhalefat el-vakia fil
mekabir**

Autor: Halid Shaijië

Botues: LIB-ART

Botimi i parë

Përktheu nga gjuha arabe:	Esat Qestaj
Recensent fetar:	Lulzim Susuri
Redaktimi gjuhësor (Lektura):	Roald Hysa
Faqosja:	Gazmend Gjota
Kopertinat:	<u>kopertinat.com</u>

Copyright © 2009 **Lib-Art**.

Të gjitha të drejtat e rezervuara për
gjuhën shqipe.

Libart-botime.com

PARATHËNIE

Allahut të Lartësuar i takon falënderimi, Atë e falënderojmë dhe vetëm nga Ai ndihmë dhe falje kërkojmë, tek Ai mbështetemi nga sherri i vetes dhe i veprave tona, kë e udhëzon Allahu i Lartësuar, s'ka kush ta humbë, e kush është i humbur s'ka kush e udhëzon tjetër përveç Allahut.

Dëshmoj se s'ka zot tjetër që adhurohet me meritë përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, është rob dhe i dërguar i Tij. Paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij, mbi vëllezërit e tij profetë, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë pasuesit e sinqertë.

Nuk ka dyshim se Sheriati Islam është një legjislacion shumë i plotë dhe gjithëpërfshirës. Aty janë përmbledhur të

gjitha çështjet e kësaj jete përmes të cilave i garanton lumturi robërve në këtë botë dhe në botën tjetër. Ky legjislacion përmban në vetvete edhe rregullat konstante përmes të cilave ua mundëson njerëzve ngritjen e tyre në normat e kërkuara në të cilat ata urdhërohen të jenë.

Prej çështjeve që ka shtjelluar Sheriati Islam janë edhe dispozitat dhe edukata që ka të bëjë me varrezat dhe vizitën e tyre. Islami i kushtoi rëndësi largimit nga çdo vepër e ndaluar gjatë vizitës së varreve, duke pasur kujdes mosrënien në shirk, në bidate dhe mëkate të tjera në të cilat shumë njerëz sot bien në to pa kurrfarë frike, dhe në anën tjetër po ky Sheriat i kushtoi rëndësi edhe vizitës së varrezave, duke e treguar dhe duke nxjerrë në pah një nga qëllimet primare gjatë vizitës së tyre, e i cili është respekti i varreve. Kjo bëhet për shkak të respektit që ka Islami ndaj besimtarëve të vdekur, sepse

muslimani është i nderuar, si i gjallë, ashtu edhe i vdekur.

Nga disa njerëz kam vërejtur raste të shumta, të cilat bien ndesh me rregullat e sheriatit gjatë vizitës që ata u kanë bërë të afërme apo dashamirëve të tyre, apo edhe kur i kanë vizituar varrezat në përgjithësi. Prandaj dëshira për t'u kapur sa më fort pas të vërtetës, për ta pasuar atë dhe për ta qartësuar sa më mirë të vërtetën vendosa t'i shkruaj këto rreshta, duke shpresuar se do të jenë të dobishëm.

Lus Allahun e Lartësuar të na udhëzojë të gjithëve tek e mira, veprat tona t'i bëjë sa më të sinqerta, të na shpërblejë me xhenetet e Tij, të na ndihmojë që ta përmendim, ta falënderojmë dhe të jemi sa më të devotshëm ndaj Tij. Atë e lusim të na e largojë çdo mundësi përmes së cilës mund të fitojmë hidhërimin dhe dënimin e Tij, dhe

të na mundësojë të dalim sa më lehtë nga kjo botë, dhe çdo punë të nisur ta përfundojmë sa më mirë.

Lus Allahun që varrezat tona, pasi të kemi vdekur, dhe të vëllezërve tanë muslimanë të na i bëjë kopshte prej kopshteve të xhenetit, e Ai është i Vetmi që dëgjon dhe i përgjigjet lutjeve tona. Salavatet dhe selamet qofshin për të Dërguarin e Tij, Muhamedin.

Dispozitat dhe vlera e vizitës së varrezave, si dhe përcjelljes së xhenazes nga burrat

Të gjithë dijetarët janë të pajtimit se vizita e varrezave dhe përcjellja e xhenazeve nga burrat është e lejuar dhe një vepër e tillë përmban në vetvete shpërblim të madh. Kjo që përmendëm vlen vetëm për gjininë mashkullore e jo edhe për atë femërore.

Në vazhdim do të përmendim argumente, të cilat flasin për këtë çështje, duke mos lënë anash edhe përmendjen e disa urtësive pse grave u ndalohej një vizitë e tillë.

Dispozitat që e lejojnë vizitën e varreve dhe përcjelljen e xhenazeve nga ana e burrave:

Imam Muslimi shënon në “Sahihun”¹ e tij nga Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, se ka thënë: “*Ua pata ndaluar vizitën e varrezave, kurse tani vizitojini ato*”.

Në një transmetim thuhet: “*Sepse ajo vizitë ua kujton ahiretin*”², ndërsa në një transmetim tjetër thuhet: “*Vërtet ajo ua kujton vdekjen*”

Në një transmetim tjetër shënohet: “*Vërtetë ajo i zbut zemrat e bën syrin të*

¹ Hadithi nr. 977, 1977.

² Shënon Ebu Davudi, nr. 3698, Nesaiu, 4/73, nga Enesi. Gjithashtu shënon Tirmidhiu nr. 939, Ahmedi në “Musned”, 5/355, nga Burejde b. Husajni, radijallahu anhu.

lotojë, e kujton ahiretin dhe në to kini kujdes të mos flisni fjalë të ndyra.”³

Po ashtu në një transmetim thuhet:
“Ngase kjo lloj vizite e largon dashurinë e dynjasë nga zemra dhe të kujton botën tjetër”⁴... “E bën të dashur ahiretin”⁵.

Vlera e përcjelljes së xhenazes:

Buhariu dhe Muslimi shënojnë nga Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, se i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ve selem*, ka thënë: *“Kush fal namazin e xhenazes dhe nuk merr pjesë në përcjelljen e saj deri tek varrezat do të shpërblehet me një kirat, e*

³ Shënon Hakimi, 1/532, nga Enesi, radijallahu anhu.

⁴ Shënon Ibën Maxhe, nr. 1571, nga Ibën Mesudi.

⁵ Shënon Ibën Hibani, 3/261.

nëse e fal namazin e saj dhe e përcjell deri sa të varroset, ai do të shpërblehet me dy kiratë shpërblim”. I Dërguari, salallahu alejhi ve selem, u pyet se çfarë është kirati? E Ai tha: “Kirati është shpërblim, më i vogli i të cilëve është sa kodra e Uhudit”⁶

Vlera e pjesëmarrjes në varrimin e xhenazes:

Muslimi nga Theubani, Allahu qoftë i kënaqur me të, shënojnë se Profeti, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “*Kush e fal namazin e xhenazes, ai do të ketë një kirat me shpërblim, kurse kush merr pjesë në varrimin e saj do të ketë dy kiratë me*

⁶ Shënon Buhariu, nr. 1261 dhe Muslimi, nr. 945.

*shpërblim, e kirati është i madh sa kodra e Uhudit*⁷.

Nga argumentet e lartpërmendura vërehet shumë qartë shpërblimi i madh që kanë në vetvete këto punë. Përveç kësaj përmes tyre besimtari kryen edhe detyrimin e tij, që ka ndaj vëllait të tij musliman. Këtë detyrim vëllai musliman e ka ndaj vëllait tjetër, edhe atëherë kur ky i fundit ka vdekur dhe ka kaluar në botën tjetër. Gjëra të cilat e nxisin besimtarin e devotshëm të bëjë sa më shumë vepra të tilla e kështu përmes tyre të arrijë shpërblim të madh dhe në anën tjetër të kryejë një detyrim të tij personal ndaj vëllezërve të tij muslimanë.

Në të dy librat e sakta të hadithit shënohet nga Ebu Hurejre, radijallahu anhu, se Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, ka

⁷ Shënon Muslimi, nr. 946.

thënë: “*Detyrimet e muslimanit ndaj vëllait të tij musliman janë gjashtë.*” Shokët e tij e pyetën se: Cilat janë, o i Dërguar i Zotit? Ai, *salallahu alejhi ve selem*, tha: “*Kur ta takosh përshëndete me selam, nëse të fton përgjigju ftesës së tij, nëse të kërkon ta këshillosh këshilloje, kur të teshtihet dhe e falënderon Allahun thuaji: Allahu të mëshiroftë, e nëse sëmuret vizitoje, dhe nëse vdes përcille xhenazen e tij*”.⁸

Për sa i përket vizitës së varrezave dhe përcjelljes së xhenazeve nga gratë sheriati i pastër Islam e ka ndaluar një vepër të tillë.

Një ligj i tillë është përcjellur nga i Dërguari, *salallahu alejhi ve selem*, në disa hadithe të tij, ndër të cilët janë edhe këto:

⁸ Shënon Buhariu, dhe Muslimi, nr. 2162.

Ahmedi, Tirmidhiu, Ibën Maxhe, Ibën Hibani⁹ e të tjerë shënojnë nga Ebu Hurejre, radijallahu anhu, se i Dërguari, *salallahu alejhi ve selem*: “*I ka mallkuar vizitueset e varrezave*”.

Dijetarët kanë bërë disa hulumtime rreth urtësive të ndalimit të vizitës së varrezave nga gratë, ku edhe kanë përmendur disa prej tyre, e ato janë:

1- Mbrojta e ndjenjave të tyre të buta dhe ruajtja e tyre nga shtimi i mërzisë dhe

⁹ Musned, 2/337, 356, Xhamiu et-Tirmidhi, nr. 1056, Sunen ibën Maxhe, nr. 1576, Sahih Ibën Hiban, nr. 3178. Hadithin ka edhe transmetime të tjera që e dëshmojnë atë. Këto hadithe të tjera gjenden në Ibën Maxhe, nr. 1575, nga Abdullah b. Abasi. Gjithashtu tek Ahmedi, 3/442 dhe Ibën Maxhe, nr. 1474 nga Hasan b. Thabiti.

ndikimi i madh negativ nga një fatkeqësi e tillë.

2- Mëshirë për to dhe për shikimin e tyre, për shkak të durimit të mangët që kanë.

3-Dalja e tyre nga shtëpia mund të sjellë deri tek moskryerja e detyrimeve të saj ndaj burrit.

4- Duke pasur parasysh faktin se ato durojnë shumë pak e në anën tjetër ndikohen nga mërzia e tyre, ku edhe ndodh që t'i zbulojnë pa qëllim disa pjesë të trupit të tyre.

5- Shpesh ndodh që kur ato vizitojnë varrezat fillojnë të bërtasin dhe të vajtojnë, t'i shkulin flokët dhe të bëjnë shumë vepra të tjera jo të pëlqyera duke e vënë kështu në

sprovë veten gjithashtu edhe të tjerët, ngase ato nga natyra e tyre janë të dobëta.

Mbi të gjitha është fakti se edhe sikur këto veti negative të mos paraqiteshin në një vizitë të tillë do të mjaftonte për gratë të largoheshin nga një vepër e tillë, me qëllim që të pasonin urdhrin e Sheriatit Islam, i cili i mëson ato të largohen nga vizita të tilla.

DISA GABIME QË NDODHIN GJATË VIZITËS SË VARREZAVE

Nga disa njerëz ndodh që gjatë vizitës së tyre të varreve apo edhe gjatë varrosjes së xhenazeve të bëjnë gabime dhe kundërvajtje, të cilat i ndalon Islami.

Gabime të tilla, në shumicën e rasteve ndodhin pa qëllim apo duke menduar, se një vepër e tillë është e lejuar apo edhe nga mosinteresimi i njerëzve për të mësuar se çfarë duhet të bëjë besimtari kur atij i ndodh ndonjë fatkeqësi në familje, ku si shkak i saj ndodh që njeriu nga mërzia të mos e kontrollojë veten e tij, por të bjeri ndesh me disa rregulla dhe kërkesa Islame.

Në rreshtat në vijim do të përmendim disa gabime në të cilat zakonisht bien

njerëzit gjatë vizitës së tyre të varrezave. Këto vërejtje zakonisht janë marrë nga fjalët e dijetarëve, Allahu i mëshiroftë, të cila janë:

1- Mosnjohja e dispozitave, se si besimtari duhet të veprojë kur xhenazja kalon afër tij:

Rreth këtij rasti disa njerëz mendojnë që qëndrimi në këmbë gjatë kalimit të xhenazes është detyrim (vaxhib), kurse disa të tjerë e ndalojnë atë duke e konsideruar haram.

Kurse mendimi më i saktë është ai, se nëse pranë nesh kalon ndonjë xhenaze, atëherë është e pëlqyer (mustehab) për besimtarin që të ngrihet në këmbë derisa të kalojë xhenazja, edhe nëse kjo e fundit nuk i takon radhës së muslimanëve, por është prej jomuslimanëve. Ky është mendimi rreth të

cilit është përmendur hadithi i saktë i Profetit, *salallahu alejhi ve selem*.¹⁰

Imam Tirmidhiu thotë: Na përcjell Kutejbe nga Lejthi, ky prej Jajhja b. Seidit, ky nga Vakidi, i cili është Amër b. Sad b. Muadhi, ky nga Nafi b. Xhubejri, nga Mesudi b. Hakemi, nga Ali b. Ebi Talibi, se kishte përmendur, që i Dërguari, *salallahu alejhi ve selem*, kishte qëndruar në këmbë tek xhenazja kur ajo po varrosej, kurse pas ca kohe nuk qëndronte më në këmbë, por ulej. Imam Tirmidhiu për këtë hadith thotë: “Hadithi është hasen sahih, këtë hadith e transmetojnë katër tabiinë njëri nga tjetri dhe me dispozitën e cekur në të punojnë disa dijetarë. Imam Shafiu thotë: “Mendimi se ngritja në këmbë kur të kalojë xhenazja afër është e pëlqyer është mendimi më i

¹⁰ Shënon Muslimi, nr. 961, Ebu Davudi, nr. 3147 dhe Nesaiu, nr. 1922.

saktë në këtë kapitull, dhe ky hadith (i lartpërmendur) është derogues i hadithit: “Kur ta shihni duke kaluar xhenazja ngrihuni për të në këmbë”. Kurse Ahmedi thotë: “Nëse do ngrihet në këmbë e nëse do nuk ngrihet”, duke u argumentuar me rastin e Profetit, *salallahu alejhi ve selem*, se ai për një kohë ishte ngritur e më vonë filloi të mos ngrihej. I këtij mendimi është edhe Is-hak b. Ibrahim. Tirmidhiu vazhdon të thotë: “Domethënia e fjalës së Aliut; një herë ngrihej e pastaj filloi të mos ngrihej, ka si qëllim pra rastin, se i Dërguari, *salallahu alejhi ve selem*, kur shihte xhenaze ngrihej në këmbë e pastaj nuk ngrihej më kur shihte raste të tilla”¹¹.

Kjo ngritje në këmbë nuk nënkupton adhurimin apo madhërimin e të vdekurit, por ajo veprohet për shkak se i vdekuri ka

¹¹ Këto fjalë të Tirmidhiut gjenden në Sunenin e tij tek hadithi nr. 1044.

respekt dhe vlerë të veçantë, që nuk duhet ta lërë anash besimtari. Njëherit mendimi i lartpërmendur është edhe mendim i dijetarit të nderuar të këtij shekulli Abdulaziz b. Abdullah b. Bazit, Allahu e mëshiroftë.

2- Disa njerëz e falin namazin e xhenazes dhe prezantojnë në varrim me syfaqësi, apo për shkak se diçka e tillë është traditë vendase, apo se i vdekuri është i afërt apo shok i tij:

Pa dyshim që shpërblimi i përmendur nëpër hadithe lidhur me faljen, përcjelljen dhe varrosjen e xhenazes arrihet vetëm atëherë kur njeriu që është i pranishëm në një ceremoni të tillë këtë vepër duhet ta bëjë duke shpresuar shpërblimin e Allahut dhe

qëllimi i tij duhet të jetë për hir të Zotit, ngase çdo punë shpërblehet sipas qëllimit të saj.

Buhariu shënon në Sahihun e tij¹² nga Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, se Muhamedi, *salallahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Kush e përcjell xhenazen e muslimanit me besim të plotë, duke shpresuar në shpërblim, vazhdon të jetë i pranishëm derisa t’i falet namazi dhe derisa të varroset, ai njeri do të kthehet me shpërblimin e dy kirateve, e kush fal namazin dhe kthehet para se të varroset xhenazja kthehet me një kirat shpërblim.*”

Ibën Haxheri, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Ndërlidhja e shpërblimit të këtyre punëve me besim dhe shpresë për shpërblim është i patjetërsueshëm, sepse arritja e shpërblimit

¹² Shënon Buhariu, nr. 47.

për çdo punë kushtëzohet me nijetin e mirë paraprak. Ndërsa ata që nuk e bëjnë me nijet të mirë, atëherë vepra e tyre konsiderohet thjeshtë kryerje e detyrimit të mëhershëm, apo atij të mëvonshëm, të cilin njerëzit e bëjnë për njëri-tjetrit, apo nga dashuria dhe respekti që kanë mes vete.”¹³

3- Disa njerëz që prezantojnë në varrim, sidomos përgjegjësit që merren me mbulimin e xhenazes me dhe’ flasin shumë, ku shpesh edhe fjalë jo të mira:

Ka raste ku çdo punëtor gjatë varrosjes së xhenazes dëshiron që ideja e tij të realizohet, apo mendon se fjala e tij është ajo me e arsyeshmja, duke u munduar që t’i bindë të tjerët për atë që thotë, apo atë që mendon.

¹³ Fet-h el-Bari, 3/198.

Për fat të keq ndodh në disa raste që ata edhe të fjalosen duke u armiqësuar mes vete e sidomos kur në mesin e tyre ka injorantë, që nuk kanë dije rreth këtyre çështjeve dhe rreth mënyrës së zbritjes së xhenazes në varr dhe mbulimit të saj me dhe’.

Prandaj nuk ka kurrfarë dyshimi se raste të tilla janë gabime të mëdha dhe gjithsesi duhet t’i largohemi atyre. Në këso tubimesh duhet të mbretërojë qetësia dhe respekti, duke mos i harruar lutjet për të vdekurin dhe mësimet për veten tonë, të cilat i përfitojmë nga ngjarje të tilla. Me këtë rast na mjafton të përmendim sa për ta pasur parasysh, se si e përshkruan Bera b. Azibi, radijallahu anhu, pjesëmarrjen e tij në një prej varrimeve së bashku me të Dërguarin, *salallahu alejhi ve selem*, në të cilin ai e përshkruan me imtësi këtë ngjarje për të cilën thotë: “U ulëm përreth Profetit, *salallahu alejhi ve selem*, dhe qëndronim aq

qetë, sikur mbi kokat tona të qëndronin zogjtë.”¹⁴

¹⁴ Hadithi i Bera b. Azibit flet për daljen e shpirtit të besimtarit dhe të qafirit dhe çfarë ndodhë pas atij rasti me ta në varr. Ky transmetim përmendet me zinxhirë të shumtë transmetuesish, atë e përcjell Ahmedî, në Musned, 4/287, 295, Ebu Davudi, nr. 3210, Nesaiu, nr. 1/282, Ibën Maxhe, nr. 1548, 1549, dhe disa dijetarë të tjerë me fjali më të shkurtra e disa të tjerë me më të gjata. Hadithin në fjalë e saktëson dijetari i famshëm Ibën Kajimi, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij “Tëlam el-Muvekiinë” 1/214, kurse në librin “Tehdhibus-sunen” 4/337. Rreth fjalive, përmbajtjes dhe rrugëve të transmetimit të këtij hadithi janë interesuar të flasin shumë dijetarë, prej tyre hafidhi dhe komentuesi i Kuranit, Ibën Kethiri në Tefsirin e tij, 2/131, Ibën Haxheri në “Fet-h el-Bari” 3/234-240, dhe dijetari i hadithit Albani në

Pra, sikur zogjtë t'i shihnin do të uleshin mbi kokat e tyre dhe nuk do të largoheshin prej tyre, për shkak se sahabët kur prezantonin nëpër varrime nuk lëviznin nga qetësia dhe heshtja, duke mos bërë asnjë lëvizje e as duke mos bërë kurrfarë bisede. Zogu sikur t'i shihte do të mendonte se janë gjëra të ngurta, sepse mbi ta dhe në të tilla tubime të tyre mbretëronte qetësia dhe respekti maksimal i mundshëm.

Gjithashtu në tubime të tilla kërkohet nga të pranishmit, që t'i dëgjojnë dijetarët, nëse ndonjë prej tyre është i pranishëm në ato tubime. Tërë këto që po themi çdokush prej nesh duhet ta ketë parasysh. Kjo për arsyen se falja e namazit të xhenazes, vendosja e saj në varr dhe mbulimi me dhe',

librin e tij “Ahkamul-xhenaiz”, fq. 198-202, Allahu i mëshiroftë dhe i shpërbleftë të gjithë dhe i shpërbleftë ata dhe neve me xhenet.

të gjitha këto pra, janë adhurime që çdo besimtar duhet t'i praktikojë në formën e tyre të kërkuar, sipas Sheriatit dhe sipas asaj që është përmendur në hadithet e Profetit, *salallahu alejhi ve selem*. Gjithmonë duhet pasur parasysh që njerëzve të ditur t'iu jepet mundësia të flasin në raste të tilla, sepse dijetarët dhe nxënësit e dijes janë ata që kanë dije më shumë se të tjerët rreth këtyre çështjeve dhe si të tillë e meritojnë t'u jepet fjala dhe t'i dëgjojnë të tjerët.

4- Disa njerëz gabojnë duke i ngritur varret mbi tokë më shumë se një pëllëmbë:

I Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ve selem*, ka urdhëruar që varrezat e ngritura mbi sipërfaqen e tokës të rrafshoheshin. Gjithashtu varri i vet Profetit, *salallahu alejhi ve selem*, nuk u ngrit nga sahabët sa të dallohej nga varret e tjera. Ata, Allahu qoftë i kënaqur me ta, varrin e Profetit të tyre e ngritën mbi tokë për afërsisht një pëllëmbë e jo më shumë. Çështjen në fjalë na e përcjell Ibën Hibani në Sahihun e tij¹⁵, në hadithin e përcjellë nga Xhabir b. Abdullahi, radijallahu anhu, i cili tregon se “Profetin, *salallahu alejhi ve selem*, kur e varrosën... varrin e tij e ngritën për afërsisht një pëllëmbë”.

¹⁵ Sahih Ibën Hiban, 14/602.

Urtësia që përmban kjo çështje qëndron në faktin, se ngritja dhe madhërimi i varreve gjithashtu zbukurimi, aq sa të tërheqë shikimin e kalimtarëve shkakton fitne dhe sprovohen njerëzit e gjallë me ato varre dhe me të vdekurit që gjinden në to, mu ashtu siç ndodh sot në shumë vende të Botës Islame, gjendje kjo për të cilën lusim Allahun ta përmirësojë atë, e nuk ka ndryshim dhe forcë tjetër, e cila mund të ndryshojë përveç Allahut!

Nuk duhet harruar kurrsesi fakti, se fillimi i paraqitjes së shirkut në fytyrë të tokës ka ndodhur për shkak të teprimit me dashurinë e njerëzve të mirë dhe madhërimit të varreve. Për këtë shkak dijetarët ua tërheqin shumë shpesh njerëzve vërejtjen për rrezikun e kësaj çështje, duke ua sqaruar atyre mundësinë e rënies në shirk përmes madhërimit dhe dashurisë së varrezave dhe njerëzve që janë të varrosur në

to. Prej atyre që folën rreth kësaj çështje është edhe imami dhe reformatori, dijetari Muhamed b. Abdulvehabi, Allahu e mëshiroftë, i cili për këtë problem ka veçuar një kapitull me titullin: “Kapitulli që sqaron se shkak i përhapjes së kufrit tek bijtë e Ademit ka qenë teprimi i tyre me dashurinë ndaj njerëzve të mirë (pasi ata kishin vdekur. sh.p.)”, kurse kapitullin tjetër e emëroi: “Kapitulli që tregon se teprimi në varrezat e njerëzve të devotshëm i shndërron ata në idhuj që adhurohen në vend të Allahut”, pastaj në këto kapituj ai përmend edhe argumentet e kësaj çështje me të cilat argumenton rrezikun e këtij fenomeni negativ që po vërehet dukshëm në Botën Islame, prandaj nëse dëshiron për t’i mësuar këto argumente kthehu në librin e tij, i cili flet për këto çështje. (Kitabut-Teuhid. sh.p.)

5- Disa njerëz mendojnë se spërkatja e varrit me ujë pasi të varroset i vdekuri ndikon tek ai pozitivisht apo ia flladit varrin atij:

Spërkatja e varrit është keqkuptuar nga njerëz të caktuar, qëllimi i saj është që përmes ujit dheu i vendosur në varr të kapet dhe të forcohet mes vete e kështu të mos priset varri (sidomos në vendet ku janë shkretëtirë në të cilët era mund ta zhvendosi zallin e varrit. sh.p.).

Ibën Kudame, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij: “El-Mugni”¹⁶ thotë: “Spërkatja e varrit konsiderohet vepër e pëlqyer për shkak se përmes tij dheu i varrit forcohet mes vete e kështu nuk shkapërderdhet”. Në

¹⁶ 3/436.

rregullin e lartpërmendur futet edhe vendosja e gurëve apo tullave rreth varrit. Pra ato vendosen që dheu të qëndrojë sa më shumë mbi varr e mos të largohet prej tij, gjithashtu të dallohen varret mes tyre, duke pasur hapësirë, nevojë kjo e cila vërehet me kalimin e kohës dhe që kalimtarët përreth tyre të mos i shkelin. Për këtë që përmendëm dëshmon edhe vepra e Profetit, *salallahu alejhi ve selem*, gjatë varrimit të Osman b. Medhunit, radijallahu anhu, hadith të cilin do ta përmendim pas disa rreshtave me ndihmën e Allahut.

6- Në disa vende muslimane ka njerëz që mendojnë, se vendosja luleve, apo e fletëve të hurmës është pjesë e Sheriatit, të cilin na e mëson Islami:

Në realitet një vepër e tillë është e ndaluar, sepse Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, nuk e ka vepruar asnjëherë në asnjë nga varrezat e muslimanëve në jetën e tij, përveç një rasti të caktuar, i cili konsiderohet si rast i veçantë dhe nuk lejohet të merret si shembull për rastet e tjera.

Rastin në fjalë e shënon Buhariu dhe Muslimi nga Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili thotë: “Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, kaloi pranë dy varreve dhe me këtë rast tha: “*Këta dy të varrosur këtu janë duke u dënuar. Ata nuk*

po dënohen për diçka të madhe¹⁷, për sa i përket të parit ai nuk kujdesej nga stërpikat e urinës, kurse tjetri bartte fjalë nga njëri tek tjetri.” Pastaj mori një degë të njomë hurme e ndau përgjysmë dhe i nguli në ato dy varre. Shokët e tij e pyetën: Pse veprime kështu, o i Dërguari i Allahut? E ai tha: *“Shpresoj që Allahu t’ua lehtësojë dënimin derisa fleta të thahet”¹⁸.*

¹⁷ Për ata të dy ajo punë nuk ishte e madhe, që të ruheshin prej saj. Pra, nuk kujdeseshin, sepse e konsideronin si punë të vogël, edhe pse ajo tek Allahu ishte mjaft e madhe. Gjithashtu thuhet se ajo vepër, edhe pse duket e vogël, mirëpo ajo në fakt me kalimin e kohës dhe përsëritjen e shpeshtë arriti të kalojë në mëkat të madh. Për më shumë shiko librin: “Fet-h el-bari” 1/318.

¹⁸ Shënon Buhariu, nr. 1361 dhe Muslimi, nr. 292.

Dijetari i nderuar Abdulaziz b. Bazi, Allahu e mëshiroftë, në shtojcat e tij bërë “Fet’h- el-bar-it” thotë: “Mendimi se ky rast është i veçantë dhe i posaçëm vetëm për këta dy persona është mendimi më i saktë rreth kësaj çështje. Kjo për arsye se Pejgamberi, *salallahu alejhi ve selem*, nuk ka ngulur në asnjë varr tjetër degë hurme, përveç këtyre të dyve, për të cilët e dinte se ishin duke u dënuar. Prandaj sikur të ishte kjo vepër, traditë e tij, atëherë ai do ta vepronte në çdo varr. Gjithashtu as udhëheqësit e drejtë pas tij nuk e vepruan një gjë të tillë, e sikur të ishte pjesë e Sunetit të tij, atëherë ata të parët do ta vepronin atë”¹⁹.

¹⁹ Hashijeh Fet-h el-bari, 3/223.

7- Disa njerëz, nga dashuria dhe malli për të vdekurit e tyre u shkruajnë mbishkrime të ndryshme, apo edhe ua ndërtojnë varret në mënyra nga më të ndryshmet:

Në realitet kjo vepër është e ndaluar sipas traditës profetike që na mëson Profeti, salallahu aeji ve selem. Në Sunenin e Ebu Davudit, Xhamiun e Termidhiut dhe në Sahihun e Ibën Hibanit shënohet se: *“I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, e ka ndaluar rregullimin e varrezave, shkrimin, ndërtimin dhe uljen mbi to.”*²⁰

Kurse Muslimi shënon nga Xhabir b. Abdullahu se: *“I Dërguari, salallahu alejhi ve*

²⁰ Shënon Ebu Davudi, nr. 3226, Tirmidhiu, nr. 1052, Ahmedi 3/339, Ibën Hibani, nr. 3164.

selem, e kishte ndaluar ndreqjen e varreve, uljen dhe ndërtimin mbi to”²¹.

Kurse në transmetimin e Nesaiut²² nga Xhabir b. Abdullahu, Allahu qoftë i kënaqur me të, shënohet se ka thënë: “*I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, e ndaloj ndërtimin mbi varre, shtimin e tyre, gjithashtu rregullimin e tyre.*”, në një transmetim përmendet edhe shtojca: “Të shkruarit mbi to”.

Sujutiu, Allahu e mëshiroftë, në komentin që i ka bërë Sunenit të Nesaiut,²³ thotë: “Rreth ndalimit të ndërtimit mbi varre që e bëri Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, (dijetari) Iraku gjatë komentit të tij bërë Sunenit të Tirmidhiut thotë: Ka

²¹ Shënon Muslimi, nr. 970.

²² Shënon Nesaiu, 4/86.

²³ Po aty.

mundësi që ndalimi i ndërtimit mbi varr të ketë si qëllim, që të mos ngrihet varri aspak, sa të mos e shkelin të tjerët, ashtu si veprojnë shumica e njerëzve këto kohë. Apo me të kihet si qëllim mos-ngritja e tyrbeve, xhamive apo shkollave të ngjashme me to. Në këtë mënyrë e komentoi edhe Neveviu në komentin e librit “El-Muhedheb”. Kurse Shafiu dhe dijetarët e medhhebit të tij për këtë çështje thonë: “Është e pëlqyer që varri të mos ngrihet më shumë se dheu i tij, i cili është nxjerrë nga ai varr para varrosjes së njeriut në të, pra, t’i vendoset vetëm dheu i nxjerrë nga varri, duke mos iu shtuar dhe’ tjetër, kjo për arsye që të mos ngrihet në lartësi, të cilat do të konsideroheshin të tepërta”.

Kur jemi te fjala e Profetit, *salallahu alejhi ve selem*, “*Të mos ndërtohen ato (me tulla)*” thotë Iraku: “Disa dijetarë, ndër shkaqet që kanë përmendur për ndalimin e

ndërtimit të varreve është fakti, se ato ndalohej të ndërtohen dhe të rrethohen me tulla, ngase tullat janë të pjekura me zjarr, ndërsa rrethimi i tyre me dhe' sipas Shafiut lejohet.

Rreth shkrimit mbi varre ka folur edhe hafidh Irakui, i cili një vepër të tillë e ndalon. Ai me mendimin e tij mund të ketë si qëllim çdo shkrim, atë të emrit të personit të vdekur, datën e vdekjes, apo mendimi i tij ka si qëllim shkrimin e ajeteve të caktuara nga Kurani, apo emrat e Allahut, duke menduar që përmes tyre të arrihet deri tek begatia. Kjo e fundit ndalohej, për shkak se ato shkrime me kalimin e kohës mund të shkelen, duke u zhdukur varret, apo edhe mund të thyhen e pastaj të mbulohen me dhe' nën tokë dhe kështu njerëzit të shkelen

mbi to, duke mos e ditur se çfarë kanë nën këmbët e tyre.²⁴

²⁴ Sujutiu, *Allahu e mëshiroftë*, përmend fjalën e Hakimit të shënuar në librin e tij “el-Mustedrek”, që pasi përmend hadithet e ndalimit të shkrimit mbi varre thotë: “Zinxhirët e këtyre haditheve janë të saktë, por megjithatë njerëzit nuk punojnë sipas këtyre haditheve, kjo për shkak se të gjithë dijetarët, si në lindje ashtu edhe në perëndim të botës islame vazhdojnë të shkruajnë mbi varre, vepër kjo e përcjellë gjeneratë pas gjenerate”, kurse hafidh Dhehebiu në “Muhtesarin” e tij pas kësaj fjale thotë: “Kjo që thotë Hakimi është vepër e shpikur nga ata që nuk u kanë arritur argumentet e ndalimit.” Prandaj ki kujdes, Allahu të mëshiroftë, se si ishte e paqartë kjo ndalesë për hafidh Hakimin, Allahu e mëshiroftë, edhe se argumentet e sakta

Dijetari i nderuar, Abdulaziz b. Bazi, Allahu e mëshiroftë, duke e komentuar hadithin e shënuar tek Muslimi në Sahihun e tij të transmetuar nga Xhabiri, i cili na tregon se: “Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, e ndaloi ngritjen (ndreqjen) e varrit me tulla, gjithashtu ndaloi uljen dhe ndërtimin mbi to.” thotë: “Ky hadith i saktë dhe hadithet e tjerë, të cilët kanë këtë kuptim na argumentojnë mjaft qartë, se ngritja dhe

që tregojnë ndalimin e saj janë të shumtë. Nga ky tregim kuptojmë se e vërteta mësohet nga argumentet e jo të mendohet, se e vërteta është ashtu si punojnë shumica e njerëzve pa marrë parasysh se argumentet e mbështesin apo jo. Gjithashtu nga ky rast kuptojmë se besimtarët kanë shumë nevojë të mësojnë dijen fetare dhe të jenë të mirëinformuar rreth traditës së selefit dhe punëve të cilat i bënin dijetarët e atyre kohëve.

ndërtimi mbi varre janë vepra të ndaluara, sepse si shkak i saj pason madhështimi, i cili pa kurrfarë dyshimi është njëri nga shkaqet më të mëdha për futjen në kufër, gjë e cila ka ndodhur shpesh nëpër disa vende të ndryshme të botës islame. Prandaj është detyrim i çdo dijetari dhe i besimtarëve në përgjithësi, që t'ua tërheqin vërejtjen të tjerëve dhe t'i këshillojnë për një gabim të tillë. Ndërtimi mbi varr është mëkat, por ai ndërtim nëse është ndërtim xhamie, atëherë mëkati shtohet edhe më tepër dhe mundësia për shirk është më e madhe. Për këtë çështje transmetohen hadithe të sakta nga Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, i cili i ka mallkuar shndërruesit e varreve në xhami. Ai, *salallahu alejhi ve selem*, thotë: “Popujt që jetonin para jush varret e profetëve dhe evliave të tyre i shndërrojnë në xhami, kurse

ju kini kujdes e mos i bëni varret xhami, sepse ua ndaloj një gjë të tillë.”²⁵

Mirëpo këtu është mirë të saktësohet një pikë e kësaj çështje e ai është fakti, se dijetarët me gjithë këto ndalesa në varreza e lejojnë vendosjen e një shenje mbi varr përmes së cilës do ta dallojë njeriu varrin e të afërmit të tij, kur ta vizitojë ndonjëherë. Shenjë e preferuar do të ishte vendosja e një guri të vogël te koka apo të ngjashëm me të sipas nevojës²⁶, mu ashtu siç pat vepruar edhe i Dërguari, *salallahu alejhi ve selem*, pasi e varrosi shokun e tij Osman b. Medhunin, radijallahu anhu.

²⁵ Shtojcat e Ibën Bazit bërë Fet-h el-Barit, 3/225.

²⁶ Këtë mendim e përkrah edhe dijetari Abdulaziz b. Bazi, *Allahu e mëshiroftë*. Kthehu në fetvatë e tij tek libri: Mexhmuul fetava, 13/ 199-200.

Në Sunenin e Ebu Davudit²⁷ shënohet nga Kethir b. Zejd el-Medeniu, ky nga Mutalibi, se ka thënë: “Kur vdiq Osman b. Medhuni, pasi e varrosën atë Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, urdhëroi që t’i sillnin një gur, por personi që shkoi ta sillte gurin nuk mundi ta mbartte për shkak të peshës së tij, atëherë Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, i përvoli krahët e tij dhe shkoi ta mbartte vetë gurin. Mutalibi tregon, se ai që ia kishte treguar atij këtë tregim kishte shtuar, se gjatë tregimit të këtij rasti i dukej se akoma është duke e parë bardhësinë e krahëve të Profetit, *salallahu alejhi ve selem*. Pastaj Profeti e mbarti gurin dhe e vendosi te koka e tij dhe tha: “Përmes këtij guri e mbaj mend varrin e vëllait tim dhe afër tij do të varros anëtarët e familjes sime”.

²⁷ Hadithi nr. 3206.

8- Ka njerëz, të cilët nuk i respektojnë varrezat dhe të varrosurit në to:

Shumë prej tyre i sheh që pa kurrfarë problemi t'i shkelin varret, duke mos pasur aspak dert për të vdekurit, të cilët janë të varrosur aty, gjithashtu nuk e kanë problem aspak për argumentet e qarta, që e ndalojnë një vepër të tillë.

Muslimi shënon në Sahihun²⁸ e tij nga Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, se ka thënë: “*Të uleshit mbi gaca, të cilat do t’ua digjnin rrobat e pastaj djegia e tyre t’iu arrinte edhe në lëkurë do të ishte më mirë, se të uleshit mbi varr.*”

²⁸ Hadithi nr. 971.

Me hadithe të sakta na transmetohet nga Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, se ai një ditë e kishte parë një njeri duke ecur përmes varreve me nallane, të cilin e urdhëroi menjëherë t'i zbathte ato. Na përcillet nga Bishër b. Husasijeh, *radijallahu anhu*, se ka thënë: “Isha duke ecur me të Dërguarin, *salallahu alejhi ve selem*, ku rastësisht kaluam afër varrezave të muslimanëve dhe me këtë rast tha: “*Para këtyre ka shkuar një sherr i madh*”, ndërsa pak më vonë kaluam afër varreve të mushrikëve tha: “*Para tyre ka kaluar një hajër i madh*”, kur rastësisht pa një njeri, i cili po ecte nëpër varreza me këpucë të mbathura. Ai menjëherë e thirri dhe i tha: “*O ti që i ke të mbathura këpucët dhe ecën nëpër varreza, zbathi ato.*” Shënon Buhariu dhe të tjerë.²⁹

²⁹ Nesaiu, 4/96. Ibën Maxhe, nr. 1568, Ahmedi 5/83,84,224, Ibën Hibani 7/442, Hakimi 1/529,

9- Ka njerëz, të cilët mendojnë, se xhenazen duhet ta mbulojnë patjetër me mbulesa në të cilat janë shkruar ajete të Kuranit, vepër kjo e cila nuk ka kurrfarë baze në fe:

Dijetari i nderuar, Abdulaziz b. Bazi, Allahu e mëshiroftë sa ishte gjallë pati dhënë

Bejhekiu 4/80, Tajalisi 2/153, nr. 1124. Për hadithin në fjalë Ibën Bazi thotë se është hadith i mirë, që anon tek i dobëti (la bese bihi), kurse Albani e konsideron të mirë (hasen). Prej habive të Ibën Hazmit është edhe fetvaja e tij, i cili thotë se vetëm me atë lloj këpucësh (nallane) nuk lejohet të ecet nëpër varreza, kurse me lloje të tjera po. Ibën Haxheri pas kësaj fjale të Ibën Hazmit thotë: “Kjo tregon se ai nuk i jepte mundësi logjikës të analizojë.” shiko librin: Fet-h el-bari, 3/206.

fetva, se një vepër e tillë është e ndaluar. Nga kjo vepër çdo besimtar duhet të largohet patjetër dhe sipas tij t'i tërheqësh vërejtjen Umetit për një ndalesë të tillë është detyrim për çdo besimtar. Përmes kësaj vepre padyshim mund të shkohet deri tek përçmimi i ajeteve kuranore, përmes të cilave shumë njerëz edhe sprovohen, duke menduar se ajetet e shkruara nëpër ato pëlhura i bëjnë dobi të vdekurit të mbështjellë me to, ndërsa në realitet ai i shkreti nuk ka kurrfarë përfitimi prej tyre.³⁰

³⁰ Mexhmuu fetava ve mekalat, e hirësisë së tij Abdulaziz b. Bazit, *Allahu e mëshiroftë*, 13/184, botimi i parë, viti 1420 h.

10- Disa njerëz mendojnë se i vdekuri pasi të vendoset në varr duhet t'i zbulohet patjetër fytyra:

Dijetari i nderuar Abdulaziz b. Bazi, Allahu e mëshiroftë, është pyetur edhe rreth kësaj çështje për të cilën ai thotë se nuk duhet që të zbulohet fytyra e tij, përkundrazi i mbetet e tëra e mbuluar përveç rastit kur i vdekuri ka qenë muhrim (kështu quhet njeriu, i cili është në haxh, duke qenë i veshur me dy petkat e bardha të haxhiut, që quhen ihram. sh.p.), atëherë atij i mbetet e zbuluar fytyra dhe koka. Ky lloj njeriu dallohet me këtë rit, sepse ashtu ka urdhëruar Profeti, *salallahu alejhi ve selem*, siç përmendet në të dy librat e saktë të

haditheve³¹. Ky rregull vlen për meshkujt, kurse femrës nuk i zbulohet fytyra edhe nëse ajo është muhrime, pra, edhe nëse vdes gjatë ritualeve të haxhit.³²

³¹ Në të cilët përmendet, se një haxhi gjatë riteve të haxhit e kishte rrëzuar deveja e tij dhe kishte vdekur, e Profeti me të dëgjuar rastin tha: “Lajeni me ujë dhe sidër (lloj ere e mirë) dhe qefinoseni me dy rrobat e tij të ihramit, duke pasur kujdes që të mos ia mbuloni kokën e as fytyrën, sepse ai do të ngjallet Ditën e Gjykimit duke bërë telbije (lutje e posaçme e haxhit). Shënon Buhariu, nr. 1851 dhe Muslimi, nr. 1206.

³² Mexhmuu fetava ve mekalat, e hirësisë së tij Abdulaziz b. Bazit, *Allahu e mëshiroftë*, 13/193-194.

11- Disa njerëz nuk i kushtojnë rëndësi momentit të varrimit, duke mos pasur kurrfarë respekti për të vdekurin në ato çaste:

Ka raste kur i kam parë vetë disa njerëz, që gjatë momentit të varrimit të xhenazes në varreza bisedojnë me njëri-tjetrin pa kurrfarë problemi dhe qeshin me të të madh, aq sa nga të qeshurat u hapet e tërë goja. Ka pasur raste kur disa të tjerëve u cingëronin celularët dhe pa kurrfarë turpi i përgjigjej thirrjes dhe fillonte të flasë buzë varrit në momentin kur të tjerët ishin të zënë me varrosjen e xhenazes, bisedonin së bashku për çështje të dynjasë nga më të ndryshmet, bile edhe lenin takime po në këto biseda. Disa të tjerë pyesin për udhëtimet e njëri-tjetrit, si kaluan ato, ku kishin qenë, ku është filani, çfarë ndodhi me

filanin, e shumë raste të ngjashme me to, të cilat e argumentojnë mjaft qartë mos prezencën e tyre shpirtërore në ato tubime, jo përqendrimin, mos mësimin dhe jo përfitimin nga ato raste dhe momente mjaft të ndjeshme dhe të përshtatshme për përfitim.

Të parët tanë, pra dijetarët e selefit, ishin ata që kur shihnin xhenaze e shikonin atë me syrin e përkujtimit, gjithashtu bisedat e tyre ishin biseda të njerëzve të udhëzuar, të cilët e kishin parasysh gjendjen dhe vendin ku ndodheshin. Në vijim do të përmendim disa nga shembujt e tyre:

-Na përcillet nga Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, se kur shihte ndonjë xhenaze thoshte: “Shko se edhe ne do vijmë pas teje...”

- Usejd b. Hudajri, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: “Sa herë kam marrë pjesë në varrime mendoja me vete duke i pëshpëritur vetvetes: Çka do të bëhet me këtë të vdekur dhe ku do të shkojë ai?

- Ahmeshi, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Shkonim në varrime, por nga të qarat e mëdha nuk dinim se kush ishte për t’u ngushëlluar, edhe pse shumica e tyre nuk qanin, se i dhimbsej i vdekuri, por pse i dhimbsej vetja e tyre.”

- Ibrahim Nehaiu, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Kur shkonin njerëzit nëpër varrime vërehej tek ata mërzia ditë të tëra, sikur të mos mendonin asgjë tjetër përveç vdekjes dhe gjendjes së të vdekurit.”

- Mutarrif b. Abdullah b. Shehir na përcjell nga babai i tij, se ai kur ishte në varrim dhe nëse rastësisht ndodhte që gjatë

ceremonisë së varrimit të takonte ndonjë vëlla apo të afërt të tij, që s'e kishte takuar për një kohë të gjatë e përshëndeste sikur ta kishte parë po atë ditë, duke mos treguar interesim të madh për të, sepse i tërë përqendrimi i tij ishte tek varri dhe xhenazja, aq sa ndokush që e shihte mund të mendonte se është i hidhëruar ndaj tij, mirëpo pasi kryhej varrimi shkonte tek i afërmi dhe e përshëndeste thellësisht nga zemra dhe fillonte ta respektonte dhe mirëpriste, ashtu siç veprohet me të afërmin në takimin e parë, pas një kohe të gjatë mungese.

Kjo pra ishte gjendja e të parëve tanë të mirë, kur hynin në varreza dhe gjatë ceremonisë së varrimit. Ata kishin zemra të mbushura me besim, shpirtra të frikësuar dhe sy që lotonin, prandaj edhe ne kemi shumë nevojë, që t'i largojmë nga vetvetja rrobat e pakujdesisë, t'i pasojmë hapat e

tyre, t'i edukojmë zemrat tona, që të kenë frikë-respekt dhe të marrim mësim nga të parët tanë.

Allahu na udhëzofte në atë, që është më e mirë dhe e dobishme për ne, të na i falë mëkatet neve dhe vëllezërve tanë të gjallë, apo të vdekur qofshin ata. Lus Allahun që varret tona të na i shndërrojë në kopshte prej kopshteve të xhenetit, të na e largojë mërzinë, shqetësimin dhe frikën në to. Atë e lusim që ditën kur të na ringjallë të jemi të shpëtuar dhe fitimtarë, ku te kjo lutje shpresojmë t'i përfshijmë prindërit, familjen, pasardhësit dhe vëllezërit tanë, sepse Ai është që dëgjon dhe i përgjigjet lutjeve!

Paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, Muhamedin.

Përmbajtja

PARATHËNIE 5

**Dispozitat dhe vlera e vizitës së varrezave, si
dhe përcjelljes së xhenazes nga burrat..... 9**

**Dispozitat që e lejojnë vizitën e varreve dhe
përcjelljen e xhenazeve nga ana e burrave:.....10**

Vlera e përcjelljes së xhenazes:.....11

Vlera e pjesëmarrjes në varrimin e
xhenazes:.....12

**DISA GABIME QË NDODHIN GJATË
VIZITËS SË VARREZAVE19**

1- Mosnjohja e dispozitave, se si
besimtari duhet të veprojë kur
xhenazja kalon afër tij:20

2- Disa njerëz e falin namazin e
xhenazes dhe prezantojnë në varrim
me syfaqësi, apo për shkak se diçka e
tillë është traditë vendase, apo se i
vdekuri është i afërt apo shok i tij:.....23

3- Disa njerëz që prezantojnë në varrim, sidomos përgjegjësit që merren me mbulimin e xhenazes me dhe' flasin shumë, ku shpesh edhe fjalë jo të mira:.....25

4- Disa njerëz gabojnë duke i ngritur varret mbi tokë më shumë se një pëllëmbë:.....30

5- Disa njerëz mendojnë se spërkatja e varrit me ujë pasi të varroset i vdekuri ndikon tek ai pozitivisht apo ia flladit varrin atij:.....33

6- Në disa vende muslimane ka njerëz që mendojnë, se vendosja luleve, apo e fletëve të hurmës është pjesë e Sheriatit, të cilin na e mëson Islami:35

7- Disa njerëz, nga dashuria dhe malli për të vdekurit e tyre u shkruajnë

mbishkrime të ndryshme, apo edhe ua
ndërtojnë varret në mënyra nga më të
ndryshmet:38

8- Ka njerëz, të cilët nuk i respektojnë
varrezat dhe të varrosurit në to:47

9- Ka njerëz, të cilët mendojnë, se
xhenazen duhet ta mbulojnë patjetër
me mbulesa në të cilat janë shkruar
ajete të Kuranit, vepër kjo e cila nuk ka
kurrfarë baze në fe:49

10- Disa njerëz mendojnë se i vdekuri
pasi të vendoset në varr duhet t'i
zbulohet patjetër fytyra:51

11- Disa njerëz nuk i kushtojnë rëndësi
momentit të varrimit, duke mos pasur
kurrfarë respekti për të vdekurin në
ato çaste:53

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

82

Halid, Shaijië

Disa gabime gjatë vizitës së varrezave /
Shaijië Halid ; Përktheu nga gjuha arabe Esat
Qestaj. - Botimi 1. - Prishtinë : Lib-Art, 2010. - 60
f. ; 21 cm.

Titulli i origjinalit : Tenbihat haul bad muhalefat
el-vakia fil. - Parathënie : f. 5-8

1. Qestaj, Esat

ISBN 978-9951-573-01-6